REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
INSPEKTORATI SHTETËROR I PUNËS DHE SHËRBIMEVE SHOQËRORE
DREJTORIA RAJONALE TIRANË

Nr.4204/2 Prot

Tiranë, më 29 .09 .2026

Lënda: Njoftim për ekzekutim vullnetar të gjobës administrative.

SUBJEKTIT "EURODIVERSEY AL", NIPT M31312031A
Adresa: Ruga "Shaban Bardhoshi", Zona Kadastrale nr. 8230, objekti me nr. Pasurie 2/411, Tiranë

TIRANË

Në përfundim të procesit të inspektimit të kryer nga inspektorët e Drejtorisë Rajonale Tiranë, ***ndaj subjektit "EURODIVERSEY AL", me Nipt M31312031A, është marrë Vendimi Përfundimtar i Inspektimit me Nr.ISHPSHSH-TR-2026-003058-5, datë 17.07.2026, me të cilin është vendosur masa administrative gjobë, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë***) lekë.

Pas marrjes dijeni të Vendimit Përfundimtar të Inspektimit, nga ana juaj nuk është ushtruar e drejta e ankimit administrativ pranë **Komisionit të Shqyrtimit të Ankimeve të Inspektoratit të Përgjithshëm**, brenda afateve ligjore.

Në bazë të nenit 34 të ligjit nr. 9634, datë 30.10.2006 "Për Inspektimin në Punë", i ndryshuar, ekzekutimi i gjobave administrative kryhet sipas legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative.

Gjithashtu, në nenin 15 të Ligjit për Kundërvajtjet Administrative parashikohet se:

"1. Vendimi për kundërvajtjen administrative nuk mund të ankimohet në rrugë gjyqësore nëse ligji i posaçëm parashikon të drejtën e subjektit për t'u ankuar në rrugë administrative, por kjo e drejtë nuk është ushtruar. Për ekzekutimin e tij zbatohen dispozitat e kreut V të këtij ligji."

Nga sa më sipër, ju njoftojmë se **Vendimi Përfundimtar i Inspektimit** Nr.ISHPSHSH-TR-2026-003058-5, datë 17.07.2026, në përputhje me nenet 23 dhe 24 të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative", është **shndërruar në titull ekzekutiv** dhe duhet të ekzekutohet në mënyrë vullnetare.

Në dispozitat e Kreut V të ligjit nr. 10279/2010, konkretisht në nenin 30, pika 1, parashikohet se:

"Gjoba dhe shumat që duhet të paguhen sipas vendimit për kundërvajtjen administrative, të nxjerrë në përputhje me dispozitat e këtij ligji, paguhen nga kundërvajtësi brenda 10 ditëve nga data kur është njoftuar për vendimin e dënimit me gjobë, i cili përbën titull ekzekutiv."

Në këtë kuadër, ju bëjmë me dije se pagesa e gjobës duhet të kryhet **brenda 10 (dhjetë) ditëve.** Bashkëlidhur gjeni **faturën për arkëtimin e gjobës**. Pas kryerjes së pagesës, lutemi të dërgoni **mandatin e arkëtimit** në adresën elektronike: **info@sli.gov.al**.

Në rast të moskryerjes së pagesës brenda afatit ligjor, **Drejtoria Rajonale Tiranë** do të vijojë me ndjekjen e procedurave për **ekzekutimin e detyrueshëm**, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

KRYEINSPEKTORI

Eljo Muçaj

FATURË PËR ARKËTIM

Nr. 212

Datë 25.09.2026

BANKËS _____ Llogaria e te Ardhurave

Me anë të kësaj fature kërkojmë që Banka e Nivelit të Dytë të pranoje nga klientë(persona,persona fizikë, persona juridikë), arkëtime për llogari të institucionit tonë,me emërtime,kode,numer indentifikimi dhe shuma si më poshtë

Emri Institucionit përfitues	ISHPSHSH Drejtoria Qëndrore Tiranë
Kodi Institucionit Përfitues	**1004210**
Kodi Degës së Thesarit ku vepron	**3535**
Emri i paguesit (persona/persona fizik/person juridik)	Eurodiversity AL
Numri indentifikimit të paguesit	M31312031A

	PËRSHKRIMI I TË ARDHURAVE		SHUMA
ID Detyrimi	Emertimi	Kodi llog.Ekonomike	ARKETUAR Leke
1	NR.ISHPSHSH-TR-2026-003058-5 ate 17.07.2026	7115499	50,000
	Peesedhjete mije leke		
	TOTALI		**50,000**

INSPEKTORATI SHTETËROR I PUNËS DHE SHËRBIMEVE SHOQËRORE
DREJTORIA RAJONALE TIRANË
Eljo Muçaj

Eurodiversity AL

Shënim:Për Bankat e Nivelit të Dytë
Në zbatim të nenit 30, ligji 10279 datë 25.05.2010"Për kundravajtjet administrative", fatura për arkëtim është e vlefshme për pagesë brenda 10(dhjetë) ditëve nga data e lëshimit të saj.Në të kundërt anullohet.